Në pajtim me nenin 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) dhe neneve 40 paragrafi 3 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit nga parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në seancën e 58-të, të mbajtur me datë 28.12.2021 morri

VENDIM

Procedura për lëndën me numër 12-842 të vitit 2020, e formuar pas denoncimit me numër 12-842/1 të datës 04.02.2020, e dorëzuar nga parashtrues i njohur, NDËRPRITET.

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprime të mëtejshme për faktin se lëndën në fjalë ishte regjistruar mosmarrëveshje administrative sipas të cilës procedura është në vijim dhe vepron organ tjetër kompetent.

Lënda me numër 12 -842 e vitit 2020 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Nga ana e një parashtruesi të njohur, ---------- ---------- nga --------- , është dorëzuar denoncim me numër 12- 842/1 nga 04.02.2020, sipas të cilës është formuar lënda me pretendime kundër personit ---------- Avokati shtetërorë i ----------për keqpërdorim dhe veprimit jo ligjor në procedurën për denacionalizim. Në rastin konkret bëhet fjalë për kthimin e pronës në pronësi të parashtruesit, trualli që ndodhej në ---------- në një sipërfaqe prej 5468 m^2 nga e cila janë marrë 186 m2 dhe për këtë parashtruesi për 14 vite kalendarike para organeve të administratës dhe Gjykatës Administrative ka bërë betejë ligjore për të realizuar të drejtën e tij në procedurën e shkombëtarizimit në rastin ---------- - e cila është realizuar në Komisionin për denacionalizim me seli në Komunën ---------- -.

Parashtruesi i denoncimit thekson se për patundshmërinë në fjalë nga viti 2008 deri në ditën e dorëzimit të denoncimit, Gjykata Administrative e Maqedonisë ka nxjerrë aktgjykim me të cilin në vazhdimësi e konfirmon të drejtën e tij në pronësi mbi patundshmërinë, ndërsa organet administrative nuk e kanë vepruar sipas udhëzimeve të detyrueshme dhe indikacioneve në aktgjykimet e Gjykatës Administrative dhe Gjykatës së Lartë Administrative, me të cilat janë anuluar aktet administrative të këtyre organeve administrative. Në vegës janë fotokopjet e aktgjykimeve të Gjykatës Administrative të Lartë Administrative të Republikës së Maqedonisë nga viti 2008 deri në vitin 2019, të cilat i referohen vendimeve të Komisionit për denacionalizim. Parashtruesi thekson se edhe pse Avokati i Shtetit për --------, ---------- ----------

-, e dinte të gjitha vendimet gjyqësore të formës së prerë dhe se në këtë rast bëhet fjalë për procedurë për denacionalizim dhe kthimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme personit fizik, sipas tij, duke tejkaluar dhe shpërdoruar detyrën zyrtare në funksionet që ushtron, më datë 28.03.2019. ka marrë vendim për shitjen e një pjese të pasurisë së paluajtshme për të cilën nuk ka përfunduar procedura përfundimtare për denacionalizim. Ky veprim i Avokatit të Shtetit, për parashtruesin e denoncimit, ishte i kundërligjshëm dhe për rrjedhojë, një krim ishte i dënueshëm sipas Kodit Penal, dhe në të njëjtën kohë ai vetë mori pjesë si palë në procedurën e denacionalizimit dhe në atë procedurë dy herë bllokoi procesin për denacionalizim. Për shkak të këtij veprimi të Avokatit të Shtetit dhe për shkak të mos respektimit të Ligjit për Denacionalizim, Ligjit për Tokën Ndërtimore, Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe Ligjit për Pronën dhe të Drejtat e tjera sendore, parashtruesi kërkon nga KSHPK që në tërësi të përcaktojë dhe të fillojë procedurë penale dhe të përgjegjësisë të llojit tjetës për sanksionimin e personit të paraqitur.

Me qëllim të verifikimit të pretendimeve dhe konstatimit të gjendjes faktike në rastin e denoncuar, KSHPK-ja ka dorëzuar kërkesë për mbledhjen e informatave në Komisionin për vendosjen e kërkesave për denacionalizim me seli në Komunën ---------- lidhur me procedurën e çështjes për denacionalizim. Në afatin e përcaktuar ligjërisht është marrë informacioni i kërkuar dhe nga mbikëqyrja e dokumentacionit të marrë është konstatuar kjo gjendje faktike:

- Komisioni për vendosjen e kërkesave për denacionalizim me seli në Komunën --------, ku është shpërndarë lënda, ka bërë inspektimin e lëndës dhe ka konstatuar se me shkresën ----------. - ---- datë 09.07.2021, i tërë lënda nga 21.11.2007 me të gjitha dokumentet në origjinal është dorëzuar në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë Veriore, për shkak të kontestit administrativ të regjistruar më parë.

- Kontesti administrativ është regjistruar me nr. ----------sipas ankesës së dorëzuar nga ana e parashtruesit të denoncimit, si pal e interesuar në procedurë, të cilën ankesë e dorëzoi kundër komisionit për vendosjen e kërkesave për denacionalizim me seli në komunat ----------, ----------, ----------, ----------, ----------, --------, ---------, --------- dhe ---------- , me seli në Komunën ----------, a me të cilin akt u kundërshtua ---------- datë 15.10.2020. Gjykata Administrative, lidhur me kontestin administrativ të regjistruar më 21.06.2021, është thirrur nga Ministri i Financave, nëpërmjet Komisionit, në cilësinë e të paditurit për punën juridike të padisë në fjalë, për të paraqitur një përgjigje në të cilën do të japë një deklaratë në lidhje me padinë dhe pretendimet në padi.

Nga të gjitha sa më sipër, KSHPK-ja konstatoi se në rastin në fjalë vepron organi tjetër kompetent pas kontestit të regjistruar administrativ në të cilin procedura është në vazhdim e sipër, pas së cilës vlerësoi se nuk ka elemente për veprime të mëtejshme në lëndë dhe vendosi si në diapozitivin e këtij vendimi.

KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
KRYETAR,
Biljana Ivanovska

Dorëzuar deri te:

Parashtruesi

Punoi: J.C.
Miratoi: N.B., Anëtar i KSHPK-së